Wilson Center Digital Archive
International History Declassified
digitalarchive.wilsoncenter.org

# August 7, 1964

# Declaration of the Government of the People’s Republic of Albania Concerning the Aggressive Miilitary operations of the US against the Democratic Republic of Vietnam on August 7, 1964

## Citation:

"Declaration of the Government of the People’s Republic of Albania Concerning the Aggressive Miilitary operations of the US against the Democratic Republic of Vietnam on August 7, 1964", August 7, 1964, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1964, D 251/1, p. 53 https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110199

## Summary:

This document is a declaration of the People’s Republic of Albania decrying the American military's actions on August 7 targeted against North Vietnam. According to the Albanian government, these operations endangered peace in Indochina and Southeast Asia in general in addition to violating the Geneva Convention of 1954. The American 7th Fleet and the American Air Force, along with South Vietnamese government forces, provoked a retaliatory action from North Vietnam. In addition, the Albanian government believes the Americans dispatched spies and saboteurs to North Vietnam. The Albanian government fully supports the sovereignty and independence of the North Vietnamese people in their struggle against the Americans. This declaration was distributed to all foreign diplomatic envoys in Albania.

## Original Language:

Albanian

## Contents:

Original Scan

Wilson Center Digital Archive Original Scan

I DEKLASIFIKUAR

Drejt. I - 6

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja №
Fleta:

Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Popullore te Shqiperise u paraqet nderimet e saja perfaqesive diplomatike te akredituara ne Republiken Popullore te Shqiperise dhe ka nderin t'u dergoje bashkengjitur deklaraten e qeverise se Republikes Popullore te Shqiperise mbi veprimet agresive t'armatosura te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes kunder Republikes Demokratike te Vietnamit, date 7 gusht 1964.

Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Popullore te Shqiperise perfiton nga rasti per t'u perseritur perfaqesive diplomatike ne Tirane sigurimet e konsiderates se saje te larte.-

Tirane, me 7 gusht 1964

...RFAQESIVE DIPLOMATIKE T'AKREDITUARA
... REPUBLIKEN POPULLORE TE SHQIPERISE

Wilson Center Digital Archive

Original Scan

MPJ RKIV
Viti
Dosja Fleta

DEKLASIFIKUAR

3 kopje

,58

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja
Fleta:

# DEKLARATE

## E QEVERISE SE REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE MBI VEPRIMET AGRESIVE T'ARMATOSURA TE SHTETEVE TE BASHKUARA TE AMERIKES KUNDER REPUBLIKES DEMOKRATIKE TE VIETNAMIT

Keto ditet e fundit imperialistet amerikane kryen nje provokacion shume te rende dhe nje agresion te hapet ushtarak kunder Republikes Demokratike te Vietnamit duke vene ne rrezik paqen ne Indokine dhe ne Azine Jug-lindore. Forca ushtarako-detare dhe aerore te Shteteve te Bashkuara te Amerikes shkelen integritetin tokesor dhe bombarduan vende te ndryshme te Republikes Demokratike te Vietnamit duke cenuar rende sovranitetin e saj. Per te mashtruar opinionin publik nderkombetar, personalitete te larta te qeverise amerikane deklaruan se sulmi kunder teritorit te Republikes Demokratike te Vietnamit u-be gjoja per shkak te nje sulmi ~~te paprovo-kuar~~ kunder destrojerit amerikan "Madoks" me 2 gusht 1964 dhe destrojereve "Madoks" dhe "Terner Xhoi" me 4 gusht 1964 nga anijet silurhedhese te Republikes Demokratike te Vietnamit.

Keto shpifje provokatoresh dhe luftenxitesish behen nga qeveria e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes per te mbuluar disfatat e saj ne Vietnamin e Jugut dhe per te zgjeruar luften e saj agresive edhe ne teritorin e Republikes Demokratike te Vietnamit.

Imperialistet amerikane kane kohe qe jo vetem kane bere deklarata plot zhurme mbi zgjerimin e luftes ne veri, por kane ndermarre veprimtari te ndryshme provokuese kunder Republikes Demokratike te Vietnamit. Te shumta jane rastet kur luftanijet e flotes se VII-te amerikane dhe aviacioni amerikan se bashku me anijet e qeverise kukull te Vietnamit te Jugut kane bere provokacione te vazhdueshme kunder Republikes Demokratike te Vietnamit duke kryer sulme t'armatosura dhe duke hedhur grupe spiunesh dhe diversantesh ne territorin e saj.

./.

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ ARKIV
Viti
Dosja Fleta

I DEKLASIFIKUAR

56
MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:



Ne vazhdim te ketyre provokacioneve, me 30 korrik 1964, imperialistet amerikane derguan luftanijet e tyre per te bombarduar dy ishuj te Republikes Demokratike te Vietnamit, ne Gjirin e Tonkinit, Hon Me dhe Hon Ngue. Pas ketij akti piratesk, me daten 1 dhe 2 gusht 1964 destrojeri amerikan "Modoks" shkeli ujrat teritoriale te Republikes Demokratike te Vietnamit. Perballe ketij provokacioni te ri te hapet, dhe per te mbrojtur ujrat teritoriale dhe sovranitetin e vendit te tyre, siç thuhet me te drejte edhe ne deklaraten e Ushtrise popullore Vietnameze te dates 5 gusht 1964, anijet patrulla te Republikes Demokratike te Vietnamit hyne ne veprim dhe e debuan anijen armike nga ujerat teritoriale te Republikes Demokratike te Vietnamit.

Pas deshtimit te ketij provokacioni, imperialistet amerikane, konsekuente ne politiken e tyre te luftes dhe te agresionit kunder nje vendi socialist dhe paqedashes, siç eshte Republika Demokratike e Vietnamit, kurdisen nje provokacion te ri, duke pretenduar se gjoja me 4 gusht 1964 kater silurhedhese te Republikes Demokratike te Vietnamit sulmuan dy luftanije te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes ne ujrat nderkombetare. Sikunder njofton agjensia telegrafike e lajmeve te Republikes Demokratike te Vietnamit, me 5 gusht 1964, ky eshte nje trillim koke e kembe i imperialisteve amerikane qe ka per qellim te maskoje veprimet e tyre te paligjeshme.

Siç dihet, nuk eshte hera e pare qe imperialistet amerikane fabrikojne trillime dhe organizojne provokacione te ketij lloji kunder vendeve paqedashese, me qellim qe ti nenshtroj popujt e tyre. Mjafton te permendem per kete, presionet, nderhyrjet brutale ne punet e mbrendeshme deri ne veprimet agresive ushtarake qe kane kryer ata ne Kube, Laos, Kongo etj.

Qeveria e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes i cfrytesoi ne menyre djallezore provokacionet e kurdisura prej vete saj per te

./.

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ ARKIV
Viti
Dosja Fleta

I DEKLASIFIKUAR

57

MPJ ARKIVI
Viti;
Dosja№ Fleta;



shperthyer, me 5 gusht 1964, nje sulm barbar te aviacionit amerikan kunder teritorit bregdetar te Republikes Demokratike te Vietnamit, dhe per t'i celur rrugen sgjerimit te agresionit ushtarak amerikan edhe ne teritorin e Republikes Demokratike te Vietnamit.

Te gjitha keto veprime agresive te kryera nga imperializmi amerikan perbejne nje kercenim dhe rrezik te madh per paqen dhe sigurimin e popujve te Indokines, te Azise Jug-lindore dhe per paqen ne bote.

Me veprimet e tyre te fundit kunder Republikes Demokratike te Vietnamit imperialistet amerikane e treguan edhe nje here fytyren e tyre te vertete prej agresoresh, luftenxitesh dhe armiq te betuar te vendeve dhe popujve liridashes dhe paqedashes. Qeveria e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes, me nderhyrjet e saj te vazhdueshme dhe me veprimet e saj agresive t'armatosur kunder popujve te Indokines ka shkelur ne menyre flagrante marreveshjet e Gjeneves te vitit 1954 mbi ~~Vietnamin~~ Indokinen dhe te marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1962 mbi Laosin, duke cenuar rende sovranitetin tokesor dhe lirine e popujve te ketyre vendeve. Ajo mban pergjegjesi per te gjitha pasojat qe rrjedhin nga veprimtaria e saj agresive ne kete zone.

Republika Demokratike e Vietnamit, shtet sovran dhe i pa varur, ka ndjekur dhe ndjek nje politike thellesisht paqesore dhe te bashkepunimit miqesor me te gjitha vendet. Ne interes te paqes dhe te sigurimit ne Indokine dhe ne Azine Jug-lindore, ajo ka respektuar me rigorozitet marreveshjet e Gjeneves mbi Indokinen dhe ka kerkuar vazhdimisht qe edhe shtetet te tjera te interesuara te veprojne po ashtu per te siguruar paqen ne kete zone.

Populli shqiptar dhe Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise shprehin indinjaten e tyre te thelle, denojne krimet e pergjakeshme te imperialisteve amerikane dhe protestojne energjikisht kunder provokacioneve dhe agresionit te hapur e kriminal te

./.

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ ARKIVI
Viti
Dosja Fleta

I DEKLASIFIKUAR

58

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja
Fleta:



kryer kohet e fundit nga Shtetet e Bashkuara t'Amerikes kunder Republikes Demokratike te Vietnamit. Ata kerkojne qe te ndalet me nje here agresioni i Shteteve te Bashkuara t'Amerikes kunder Republikes Demokratike te Vietnamit dhe tu jepet denimi i merituar agresoreve per krimet e tyre te shemtuara kunder popullit heroik vietnamez me te cilin populli shqiptar eshte i lidhur ngushte me nje miqesi vellazerore e te perjeteshme. Populli shqiptar admiron qendrimin burreror te popullit heroik vietnamez dhe patriotizmin e tij te larte dhe i shpreh atij ndjenjat me vellazerore si dhe solidaritetin e tij te plote per kauzen e tij te drejte e te lavdishme qe si mbron sot me kaq vendosmeri.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise perkrah plotesisht qendrimin e drejte dhe te vendosur te Republikes Demokratike te Vietnamit per mbrojtjen e lirise, pavaresise dhe sovranitetit te popullit te Republikes Demokratike te Vietnamit dhe eshte e bindur se populli vella vietnamez, duke patur dhe perkrahjen e te gjithe popujve dhe vendeve paqedashes ne bote, do te beje pa dyshim qe te deshtojne planet agresive te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes kunder Republikes Demokratike te Vietnamit.

7 Gusht 1964